

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deonitarsko Društvo

Nr. 7353 Data 29.11.2024
Njëqeveria Njëqeveria



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock
Company



PLANI I BIZNESIT PËR NDËRAMARRJEN TREPÇA SH.A. PËR VITIN 2025

Tetor, 2024

Përmbajtja

LISTA E TABELAVE	3
LISTA E FIGURAVE	4
LISTA E SHKURTESAVE	5
HYRJE	6
1. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I NDËRMARRJES TREPÇA SH.A.	7
1.1. HISTORIKU I NDËRMARRJES TREPÇA SH.A.	7
2. NJËSITË BIZNESORE DHE VEPRIMTARIA E NDËRMARRJES TREPÇA SH.A.	9
2.1. STRUKTURA LIGJORE DHE MENAXHMENTI I NDËRMARRJES TREPÇA SH.A.	10
2.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE E NDËRMARRJES TREPÇA SH.A.	11
2.3. PASQYRA E TË PUNËSUARVE NË NDËRMARRJEN TREPÇA SH.A.	12
3. VIZIONI DHE MISIONI I NDËRMARRJES TREPÇA SH.A.	12
3.1. VIZIONI	12
3.2. MISIONI	12
4. OBJEKTIVAT E NDËRMARRJES TREPÇA SH.A.	13
5. ANALIZA E MJEDISIT TË JASHTËM DHE TË BRENDSHËM TË NDËRMARRJES.....	15
5.1. MJEDISI I JASHTËM NDËRMARRJES.....	15
5.2. MJEDISI I BRENDSHËM I NDËRMARRJES	16
6. ANALIZA E INDUSTRISË MINERARE.....	17
6.1. TREGU DHE GJENDJA AKTUALE E INDUSTRISË MINERARE.....	17
6.2. PERSPEKTIVA E ÇMIMEVE TË METALEVE TË PLUMBIT DHE ZINKUT NË TREGJET BOTËRORE	19
6.3. KONKURENCA NË SEKTORIN MINERAR.....	21
7. PROJEKSIONI I PRODHIMIT NË NJËSITË BIZNESORE TË NDËRMARRJES TREPÇA SH.A.....	23
8. PROJEKSIONI I TË HYRAVE DHE SHPENZIEMVE NË NJËSITË BIZNESORE TË NDËRMARRJES TREPÇA SH.A.	24
9. PROJEKSIONI I INVESTIMEVE KAPITALE NË NJËSITË BIZNESORE TË NDËRMARRJES TREPÇA SH.A.....	43
10. PROJEKSIONI I BURIMEVE NJERËZORE NË NJËSITË BIZNESORE TË NDËRMARRJES TREPÇA SH.A.....	66
11. PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2025.....	67
REFERENCAT.....	69

Lista e Tabelave

Tabela 2. 1. Aksionarët në Ndërmarrjen Trepça Sh.A.	9
Tabela 2. 2. Njësitë Biznesore të Trepça Sh.A sipas Ligjit Nr. 05/L -120 dhe statutit	9
Tabela 2. 3. Numri i punëtorëve në Ndërmarrjen Trepça Sh.A.	12
Tabela 4. 1. Objektivat e strategjike të ndërmarrjes Trepça Sh.A.	14
Tabela 5. 1. Ndikimi i mjedisit të jashtëm	15
Tabela 5. 2. Swot Analiza	16
Tabela 7. 1. Planifikimi i prodhimit në Njësitë Biznesore produktive për vitin 2025.....	23
Tabela 8. 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg për vitin 2025	24
Tabela 8. 2. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg për vitet 2026-2027	25
Tabela 8. 3. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë për vitin 2025	26
Tabela 8. 4. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë për vitet 2026-2027	27
Tabela 8. 5. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Kopaonik – Leposaviç për vitin 2025....	28
Tabela 8. 6. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Kopaonik – Leposaviç për vitet 2026-2027	30
Tabela 8. 7. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Metalurgjia e Zinkut për vitin 2025	31
Tabela 8. 8. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Metalurgjia e Zinkut për vitet 2026-2027	32
Tabela 8. 9. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Industria Kimike për vitin 2025	33
Tabela 8. 10. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Industria Kimike për vitet 2026-2027	34
Tabela 8. 11. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Fabrika e Pajimeve të Procesit për vitin 2025	35
Tabela 8. 12. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Fabrika e Pajimeve të Procesit për vitet 2026-2027	36
Tabela 8. 13. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Fabrika e Akumulatorëve për vitin 2025	37
Tabela 8. 14. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Fabrika e Akumulatorëve për vitet 2026-2027.....	38
Tabela 8. 15. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Menaxhment për vitin 2025	39
Tabela 8. 16. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Menaxhment për vitet 2026-2027	40
Tabela 8. 17. Planifikimi i shpenzimeve në Njësinë Biznesore Stabilimentet Energjetike për vitet 2026-2027	41
Tabela 8. 18. Planifikimi i shpenzimeve në Njësinë Biznesore Stabilimentet Energjetike për vitet 2026-2027	42
Tabela 9. 1. Planifikimi i investimeve kapitale në njësitë biznesore të ndërmarrjes për vitin 2025.....	43
Tabela 9. 2. Planifikimi i investimeve kapitale për NJBST për vitin 2025.....	45
Tabela 9. 3. Planifikimi i investimeve kapitale për NJBMFKA për vitin 2025.....	55
Tabela 9. 4. Planifikimi i investimeve kapitale në NJBMKFL për vitin 2025	57
Tabela 11. 1. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse në njësitë biznesore për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025	67
Tabela 11. 2. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse sipas njësive biznesore për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025.....	68

Lista e Figurave

Figura 2. 1. Organogrami i Ndërmarrjes Trepça Sh.A.....	11
Figura 6. 1. Vendet kryesore prodhuese të Pb dhe Zn.....	18
Figura 6. 2. Minierat më të mëdha të prodhimit të Zinkut në botë	18
Figura 6. 3. Kompanitë më të mëdha prodhuese të Pb në botë	19
Figura 6. 4. Trendi i çmimeve të Plumbit dhe Zinkut gjatë dekadës së fundit	20
Figura 6. 5. Roli i faktorëve konkurrues	22
Figura 10. 1. Vlera e planifikuar e investimeve kapitale për vitin 2025	44

Lista e Shkurtesave

SH.A.	Shoqëri Aksionare
NJBST	Njësia Biznesore Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg
NJBMFKA	Njësia Biznesore Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë
NJBMFKL	Njësia Biznesore Minierat me Flotacion Kopaonik - Leposaviç
NJBFPP	Njësia Biznesore Fabrika e Pajimeve të Procesit
NJBFA	Njësia Biznesore Fabrika e Akumulatorëve
NJBIK	Njësia Biznesore Industria Kimike
NJBMZ	Njësia Biznesore Metalurgjia e Zinkut
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës
TD	Terminali Doganor
BV	Burimet Vetanake
K/Pb	Koncentrat i Plumbit
K/Zn	Koncentrat i Zinkut
LME	London Metal Exchange

Hyrje

Plani i Biznesit për vitin 2025, është planifikim i synimeve kryesore të njësive biznesore të ndërmarrjes Trepça Sh.A. Ky plan i biznesit është dokument bazë për menaxhimin e të gjitha njësive biznesore të ndërmarrjes Trepça Sh.A. për vitin 2025.

Plani i Biznesit është hartuar duke marrë parasysh informatat e dy viteve të kaluara dhe ofron projeksion të detajuar lidhur me afarizmin e njësive biznesore në ndërmarrjen Trepça Sh.A. për vitin 2025. Plani, definon qartë orientimet zhvillimore të ndërmarrjes Trepça Sh.A., objektivat dhe rezultatet e pritshme.

Plani i Biznesit është hartuar marrë parasysh gjendjen reale të ndërmarrjes Trepça Sh.A. si dhe rrethanat dhe rreziqet aktuale globale me të cilat ballafaqohet industria e minierave në tregjet globale dhe si i tillë definon qartë rrugën e afarizmit të Ndërmarrjes Trepça Sh.A., për vitin 2025.

Plani i Biznesit definon qartë orientimet zhvillimore të Ndërmarrjes Trepça Sh.A., objektivat si dhe rezultatet e pritshme duke marrë për bazë edhe rezultatet e arritura në periudhën paraprake. Si i tillë Plani i Biznesit 2025, përcakton afarizmin e Ndërmarrjes Trepça Sh.A. për vitin 2025 marrë parasysh përparësitë dhe rreziqet me qëllim të arritjes së qëndrueshmërisë financiare të Ndërmarrjes Trepça Sh.A.

1. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I NDËRMARRJES TREPÇA SH.A.

1.1. Historiku i Ndërmarrjes Trepça Sh.A.

Për Trepçën si vendburim xeheror dihet që nga koha e sundimit të Romakëve në këto vise (bazuar në dokumentin në arkivin e Dubrovnikut të vitit 1303), mirëpo eksploatimi modern i “Trepçës” ka filluar në vitin 1927, nga ana e shoqërisë aksionare Trepça Mine Ltd., e themeluar në Londër, ku në këtë periudhë fillon “jetën” Trepça e sotme. Prodhimi i rregullt në Trepçë, fillon në vitin 1930 dhe për një kohë shumë të shkurtër, Trepça ishte shtylla kryesore industriale e ekonomisë së Kosovës. Në vitin 1940, fillon punën e rregullt shkëritorja e Plumbit, në të cilën, në furra korritore, në mënyrë mjaft primitive prodhohej Plumbi lëndor. Në vitin 1950, u ndërtua furra e parë në Metalurgjinë e Plumbit e ashtu quajtura furra “C”. Investime më serioze bëhen në vitin 1964, kur u ndërtua fërgorja dhe dy furra.

Në vitin 1964, në Trepçë integrohen të gjitha minierat e Plumb – Zinkut dhe të gjitha ato me integrimin në Trepçë kalojnë në fazën e investimeve. Në vitin 1967, fillon punën e rregullt Metalurgjia e Zinkut dhe Fabrika e Akumulatorëve në Mitrovicë, kapaciteti i parë për përpunimin e metaleve të Trepçës. Pas vitit 1974, bëhet kthesë e rëndësishme edhe në Trepçë nga aspekti i formimit të një strategjie të re të zhvillimit. Përgatiten dokumentacionet dhe projektet për ndërtimin e kapaciteteve për finalizimin e metaleve të Trepçës.

Gjatë viti 1980-1981, lëshohen në prodhim të rregullt pothuajse në të gjitha qendrat e Kosovës, fabrikat me kapacitet të madh. Në Mitrovicë, lëshohet faza e dytë e akumulatorëve dhe baterive starter të Plumbit. Në Pejë, fabrika e baterive industriale. Në Gjakovë, Metaliku-fabrika e telit, gypave dhe litarëve të Zinkuar dhe rondelave të Zinkut. Në Prizren, Famipa-fabrika për përpunimin e prodhimeve të Argjendit, elektro-kontakteve, brisqet, skalperat dhe “S-cajgat”. Në Gjiilan, fabrika e Ni-Cd-bateritë sekondare dhe të litiumit. Në Vushtrri, fabrika e llamarinës së Zinkuar. Në Skenderaj, fabrika e municionit të gjuetisë. Paralelisht investohet në modernizimin dhe zgjerimin e kapaciteteve në minierën Trepça në Stan Tërg, si dhe në modernizimin dhe zgjerimin e kapaciteteve në të dy metalurgjitë.

Rënie e dukshme e prodhimit vërehet në vitet e 90'ta, si pasojë e masave të dhunshme që Qeveria e Republikës së Serbisë, në mënyrë të pa ligjshme instalonte në të gjitha Ndërmarrjet dhe institucionet e Kosovës. Si pasojë e suprimimit të autonomisë së Kosovës, fillimi i viteve 89-90-ta shënon edhe periudhën kur punëtorët dhe ekspertët e Trepçës, të përkatësisë shqiptare u dëbuan nga puna dhe fuqia punëtore u zëvendësua me punëtorë të përkatësisë etnike serbo, malazeze dhe rome. Kjo përndryshe njihet si periudha e deindustrializimit të Kosovës. Për arsye se gjatë kësaj periudhe në minierat e Trepçës është eksploatuar jashtë standardeve, pa mirëmbajtje të investimeve, me të vetmin synim shfrytëzimin joracional të pasurive në minierat e Trepçës.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, Ndërmarrja Trepça, kaloi nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit me status të pa definuar. Pas shumë përpjekjeve në nëntor të vitit 2016, Kuvendi i Kosovës e shpëtoi Trepçën nga likuidimi me nxjerrjen e Ligjit për Trepçën, me ç' rast e transformoi Trepçën në shoqëri aksionare, ku 80% të aksioneve të kësaj korporate do të janë pronë e Qeverisë së Kosovës dhe 20% të aksioneve pronë e punëtorëve të Trepçës. Në kuadër të procesit të transformimit dhe ristrukturimit me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin e Trepçës, ligji i jep të drejtën aksionarëve që në një periudhë të afërt të krijojnë mundësi për të qenë atraktive për investues privatë vendorë dhe të jashtëm, duke aplikuar format si: Partneriteti Publiko-Privat; investime direkte private; investime të përbashkëta; si dhe emetimi dhe shitja e aksioneve.

2. Njësitë Biznesore dhe veprimtaria e Ndërmarrjes Trepça Sh.A.

Ligji për Trepçën Nr. 05/L -120 përcakton transformimin e N.SH Trepça nën administrimin e AKP-së në Shoqëri Aksionare “Trepça” Sh.A me Nr. Unik Identifikues 811278747 dhe kapital fillestar 10,000.00 €.

Tabela 2. 1. Aksionarët në Ndërmarrjen Trepça Sh.A.

1	Qeveria e Republikës së Kosovës	8,000.00 €	80 %
2	Punëtorët	2,000.00 €	20 %
Kapitali		10,000.00 €	100 %

Tabela 2. 2. Njësitë Biznesore të Trepça Sh.A sipas Ligjit Nr. 05/L -120 dhe statutit

Nr	Numri i njësisë	Njësia	Vendi
1	5237742	Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg	Mitrovicë, Stantërg
2	5237769	Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë	Graçanicë,
3	5237777	Minierat me Flotacion Kopaonik - Leposaviç	Mitrovicë
4	5237785	Metalurgjia e Plumbit	Mitrovicë
5	5237793	Metalurgjia e Zinkut	Mitrovicë
6	5237807	Industria Kimike	Mitrovicë
7	5237815	Fabrika e Akumulatorëve në Mitrovicë	Mitrovicë
8	5237823	Fabrika e Pajimeve të Procesit	Mitrovicë
9	5237831	Stabilimentet Energjetike (Energjetika)	Mitrovicë
10	5237858	Laboratori në Zveçan	Mitrovicë
11	5237866	Instituti i Plumbit dhe Zinkut	Mitrovicë
12	5237874	Kompleksi Administrativ i Kishnicës në Prishtinë	Prishtinë
13	5237882	Kompleksi Administrativ në Zveçan	Mitrovicë

Produktet kryesore të cilat i prodhon dhe i plasojnë në treg Ndërmarrja Trepça Sh.A janë: Koncentrati i Plumbit dhe i Zinkut, sulfati i aluminit, prodhimi i rimorkiove dhe shërbimet e ndryshme makinerike. Trepça Sh.A. ka për qëllim primar rritjen e eksploatimit të mineraleve, hulumtimin e rezervave të shfrytëzueshme, përgatitjen dhe aktivizimin e aseteve tjera në njësitë e Trepça Sh.A. Veprimtaria e korporatës Trepça Sh.A, është kryesisht e lidhur me prodhimin e koncentratit të Pb dhe Zn.

2.1. Struktura ligjore dhe menaxhmenti i ndërmarrjes Trepça Sh.A.

Struktura ligjore e Ndërmarrjes Trepça Sh.A. është shoqëri aksionare, ku 80% të aksioneve të ndërmarrjes janë pronë e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe 20% të aksioneve janë pronë e punëtorëve të ndërmarrjes Trepça Sh.A. Përveç njësive biznesor të përcaktuara me Ligjin për Trepçën Nr. 05/L -120 dhe statutin e Trepça Sh.A., ndërmarrja Trepça Sh.A. mbështetur në studimin e fizibilitetit mund të themelon edhe njësi tjera biznesore për përpunimin e metaleve, produkteve dhe shërbimeve. Aksionet e ndërmarrjes Trepça Sh.A. janë të formës nominale, e thjeshtë ose e privilegjuar, të certifikuara ose të pa certifikuara, të letrave me vlerë, si dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës, i cili rregullon marrëdhëniet tregtare. Asetet e shoqërisë përbëhen nga asetet e njësive biznesore të përcaktuara sipas nenit 6 të Statutit dhe nenit 2 të Ligjit për Trepçën. Qëllimi i Ndërmarrjes Trepça Sh.A. është fokusi në maksimizimin e profitit dhe ngritjen e vlerës së aksioneve të ndërmarrjes. Qeverisja e Trepçës Sh.A. përbëhet nga Bordi Mbikëqyrës dhe Bordi Menaxhues. Bordi Mbikëqyrës përbëhet nga 9 anëtarë të zgjedhur nga aksionarët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital. Bordi Menaxhues përbëhet nga anëtarët e saj të cilët zgjedhën nga Bordi Mbikëqyrës, ku funksionet dhe kompetencat e saj përcaktohen me statutin e Trepça Sh.A. Në skemën e mëposhtme është prezantuar struktura organizative e Ndërmarrjes Trepça Sh.A.

2.2. Struktura organizative e ndërmarrjes Trepça Sh.A.




Figura 2. 1. Organogrami i Ndërmarrjes Trepça Sh.A.

2.3. Pasqyra e të punësuarve në ndërmarrjen Trepça Sh.A.

Ndërmarrja Trepça Sh.A. në të gjitha njësitë e veta Biznesore i ka të punësuar 2833 punëtorë. Në vazhdim prezantojmë strukturën e të punësuarve në të gjitha njësitë dhe departamentet e ndërmarrjes Trepça Sh.A. Numri i përgjithshëm i punonjësve është i bazuar në listën punonjësve të muajit shtator të vitit 2024.

Tabela 2. 3. Numri i punëtorëve në Ndërmarrjen Trepça Sh.A.

Nr.	Njësia Biznesore	Nr. Punonjësve
1	Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg	693
2	Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë	210
3	Minierat e Kopaonikut me Flotacion Leposaviç	1710
3	Metalurgjia e Zinkut	9
4	Industria Kimike	12
5	Industria e Baterive	4
6	Terminali Doganortotal	20
7	Fabrika e Pajimeve të Procesit	29
8	Stabilimentet Energjetike (Energjetika)	4
9	Menaxhment	45
10	Sigurimi	97
Gjithsej		2833

3. Vizioni dhe misioni i Ndërmarrjes Trepça Sh.A.

3.1. Vizioni

Trepça Sh.A. është korporatë prosperuese dhe lider regional në prodhimin dhe përpunimin e metaleve të Pb-Zn dhe finalizimin e tyre, në përputhje me normat mjedisore për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

3.2. Misioni

Për të siguruar një pjesëmarrje kombëtare në zinxhirin e vlerës minerare duke përvetësuar dhe duke bërë konsolidimin e një portofoli asetesh dhe shërbimesh me cilësi të lartë për palët e interesuara.

4. Objektivat e Ndërmarrjes Trepça Sh.A.

Qëllimi i Ndërmarrjes Trepça Sh.A. është zhvillimi me hapa të sigurt në drejtim të zgjerimit të kapaciteteve prodhuese në periudha afatgjata pa e rrezikuar sigurinë dhe kualitetin e produkteve dhe parimet etike e profesionale.

Plani i Biznesit i ndërmarrjes Trepça Sh.A, për vitin 2025 është përpiluar bazuar në informatat dhe analizat e afarizmit të Ndërmarrjes nga historiku dhe projeksionet analitike të tregjeve globale të industrisë minerare. Në këtë formë, Plani i Biznesit ofron informata të detajuara lidhur me afarizmin e Njësive Biznesore të Trepça Sh.A për vitin 2025. Pikëpamjet zhvillimore të Ndërmarrjes Trepça Sh.A. janë të fokusuara në:

- Stabilitet dhe qëndrueshmëri financiare,
- Menaxhimi i kostos së ulët të prodhimit dhe marzhës së lartë,
- Fokusimi në sigurimin e kujdesshëm të alokimit të kapitalit, përfshirë investimet kapitale,
- Parandalimi, zbutja dhe kontrolli i ndikimeve negative mjedisore,
- Fokusi në përdorimin e energjisë alternative në Ndërmarrje,
- Fokusi në përmirësimin e cilësisë së ajrit në miniera dhe biodiversitetin,
- Reduktim i shpenzimeve operative në të gjitha Njësitë Biznesore,
- Reduktim i borxheve të Ndërmarrjes,
- Fokusi në efikasitet dhe inovacion,
- Shëndeti, siguria dhe mirëqenia e punonjësve.

Për të siguruar që objektivat strategjike janë të balancuara ndërmjet rezultateve të prekshme dhe atyre jo materiale, Trepça Sh.A. do të përdorë metodologjinë e kartës së rezultateve të balancuara. Si të tilla, objektivat e Trepça Sh.A. janë grupuar si më poshtë.

Tabela 4. 1. Objektivat e strategjike të ndërmarrjes Trepça Sh.A.

PERSPEKTIVA E TREPÇA Sh.A.	OBJEKTIVAT STRATEGJIKE
Perspektiva për qeverisje korporative dhe përmbushja e kërkesave të aksionarëve	Sigurimi i një strukture të qeverisjes së mirë dhe plotësimi i kërkesave të palëve të interesit Zgjerimi i përgjegjësisë sociale Ristrukturimi i ndërmarrjes dhe kthimi në profitabilitet
Perspektiva për qëndrueshmëri financiare	Sigurimi i financimit të qëndrueshëm Diversifikimi i portofolios financiare Zhvillimi i sistemit të menaxhimit financiar të qëndrueshëm
Perspektiva për fokusin në zhvillim të qëndrueshëm dhe ekselencë	Zgjerimi i portofolios së produkteve Avancimi tekniko-teknologjik Rritja e kapaciteteve eksploatuese dhe përpunuese Krijimi i një kornize të qëndrueshme biznesore e bazuar në rezultate Infrastrukturë moderne
Perspektiva për vlerat, strukturën dhe stafin	Forcimi i lidhshirë dhe menaxhimit të orientuar drejt objektivave Forcimi i përgjegjësisë, llogaridhënies dhe komunikimit Edukimi i vazhdueshëm profesional Ndërlidhja mes vlerave të kompanisë, performancës dhe përgjegjësisë Adoptimi i strukturës organizative të bazuar në projekte dhe të ndërlidhur me rezultate

5. Analiza e mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Ndërmarrjes

5.1. Mjedisi i jashtëm ndërmarrjes

Tabela 5. 1. Ndikimi i mjedisit të jashtëm

Faktorët e mjedisit të jashtëm	Përshkrimi i faktorëve	Mundësitë	Rreziqet
Politik	Sistemi politik dhe Qeveritar demokratik mbështetës	Përkrahës i planifikimit dhe politikave zhvillimore të Trepça Sh.A.	Interferimet nga faktorë të jashtëm politik
Ekonomik	Kërkesa e rritur e tregut për metale. Trendet e çmimeve të volitshme dhe Stabilitet fiskal i qëndrueshëm në vend	Rritja e kërkesës për metalet e Pb-Zn dhe të hyrave. Diversifikimi i portofolios së produkteve	Lëvizjet në çmimin e bursës së metaleve dhe problemet e furnizimit të qëndrueshëm me energji
Socio-kulturor	Vlerat, normat, besimet, sjelljet dhe tendencat demografike të përshtatshme për vendin dhe sektorin	Rritja e përkushtimit përmes rritjes së vetëdijes dhe krijimit të kornizës motivuese “paguhesh sa punon”.	Motivimi i ulët për punë në miniera. Shkalla e lartë e migrimit
Teknologjik	Zhvillimet e reja tekniko-teknologjike që ndikojnë në rritjen dhe qëndrueshmërinë biznesore	Adoptimi i teknologjive moderne dhe rritja e efijencës	Pamundësia e investimit në teknologji në kohën e duhur
Mjedisor	Respektimi i normave mjedisore dhe standardeve përkatëse	Shndërrimi në ndërmarrje me përgjegjësi të lartë socio-mjedisore.	Mbetjet industriale dhe teknologjike të patrajtuara. Teknologjitë e vjetra operuese. Mostrajtimi i ujërave industrial dhe minerar
Ligjor	Sistem ligjor i përputhshëm me kornizën ligjore të EU	Perspektiva e modernizimit të veprimit të Ndërmarrjes bazuar në ligje dhe standarde të avancuara. Rishikimi i bazës ligjore për çështjet që ndërlidhen me zhvillimin e Trepça Sh.A.	Mos implementimi me kohë të ligjit për Trepçën. Kolizionet ligjore në raport me ligjin për Trepçën

5.2. Mjedisi i brendshëm i ndërmarrjes

Mjedisi i brendshëm ka ndikim të përhershëm dhe më të drejtpërdrejtë në funksionimin e Ndërmarrjes Trepça Sh.A. Qëllimi i analizës së mjedisit të brendshëm të Ndërmarrjes është të identifikojë pikat e forta dhe të dobëta të aktiviteteve të saj, pasi që për të përfutur nga mundësitë e jashtme, Ndërmarrja duhet të ketë një potencial të caktuar të brendshëm. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të njihen pikat e dobëta që mund të përkeqësojnë kërcënimin dhe rrezikun e jashtëm.

Tabela 5. 2. Swot Analiza

Fuqitë	Dobësitë
Rezervat kualitative të mineraleve të Pb dhe Zn Vendburime me resurse potenciale për të ardhmen Prodhues i vetëm i koncentrateve të Pb dhe Zn në Republikën e Kosovës. Emri i markës tregtare Licencat për vendburime dhe aktivitete të ndërlidhura Përvoja e gjatë në sektorët përkatës prodhues dhe përpunues Menaxhment i ri dhe i motivuar	Gjendja e rëndë financiare dhe borxhet e akumuluar Fuqia punëtore e moshuar Pajisjet e vjetërsuara dhe humbjet në procesin industrial Mungesa e trajnimit për punonjësit Pamundësia e zinxhirit finalizues teknologjik të përpunimit të xeheve
Mundësitë	Rreziqet
Kërkesat në rritje për koncentrat dhe metale të Pb dhe Zn Zhvillimi i zingjirit përpunues dhe finalizues Ngritja dhe funksionalizimi i Metalurgjisë së Pb dhe Zn Finalizimi i produkteve të Pb dhe Zn dhe elementeve tjera përcjellëse Potenciali organizativ Hulumtimi i vendburimeve të reja Shfrytëzimi i aseteve Riaktivizimi i Fabrikës së Baterive Industriale Valorizimi i kapaciteteve në PIM Riorientimi drejt kërkesave të tregut i Fabrikës së Pajisjeve Investimet direkte dhe PPP në pajtueshmëri me ligjet relevante	Pretendimet përmbartimore për detyrimet e akumuluar Rreziku nga joliquiditeti Oscilimet e çmimeve të metaleve në bursë ndërkombëtare Ngritja e çmimeve të furnizimeve me lëndë të parë dhe mjeteve themelore për industrinë e minierave Ngritja e çmimit të energjisë elektrike

6. Analiza e industrisë minerare

Kompanitë në industrinë e metaleve dhe minierave bazuar në disa kritereve ndahen në pesë kategori. Në veprimtari të minierave, në veprimtaritë e shkrirjes dhe rafinimit, përpunimit të metaleve, tregtimit si dhe grumbullim dhe riciklim të skrapit.

Industria minerare po kalon në periudhë pasigurie për shkak të çmimeve të paqëndrueshme të metaleve. Kjo ka bërë që industria minerare të investoj në ngritjen dhe avancimin e teknologjive në drejtim të reduktimit të kostos dhe ngritjes së produktivitetit. Investimet në teknologji e kanë transformuar dhe avancuar konkurrencën në industrinë minerare.

Krahas këtyre faktorëve industria minerare është në rritje si rezultat i teknologjive të reja dhe automatizimit të punës. Ndërmarrja Trepça Sh.A. ka qëllim kryesorë rritjen e produktivitetit dhe prodhimit si dhe ngritjen e kapaciteteve përpunuese përmes ngritjes së efikasitetit të shfrytëzimit të mineraleve, hulumtimeve të mëtutjeshme gjeologjike, si dhe modernizimin e minierave dhe flotacioneve.

6.1. Tregu dhe gjendja aktuale e industrisë minerare

Kërkesa agregate për produktet e Plumbit dhe Zinkut varet kryesisht nga industria e prodhimit të çelikut të galvanizuar, ndërtimit të lartë, industrisë automobilistike, makinerike etj. Që nga fillimi i vitit 2020, të gjitha metalet bazë kanë pësuar rënie të ndjeshme çmimesh pasi ndikimi ekonomik i pandemisë COVID-19 ka zvogëluar kërkesën agregate në industrinë e metaleve. Menjëherë pas krizës së pandemisë COVID-19, prodhimi i metaleve të Plumbit dhe Zinkut është rikthyer me kërkesë të lartë agregate, ku sipas projeksioneve të Global data, prodhimi i Zinkut pritet të arrijë në 13,9 milion ton, ndërsa prodhimi i Plumbit 5.2 milion ton deri më 2025. Kriza ekonomike e shfaqur si rezultat i luftës Rusi-Ukrainë thelloi edhe më shumë krizën në tregjet e metaleve si dhe shkaktoi shkëputjen e zingjirit të furnizimeve në Evropë. Pas rritjes me mbi 14 për qind që nga fillimi i vitit 2024, çmimet e zinkut ka të ngjarë të rriten në mënyrë modeste me një perspektivë të ngushtë të ofertës dhe parashikimin e përmirësimit të kërkesës. Sipas regjistrimeve të bazuara në Global data vendet kryesore prodhuese të Pb dhe Zn në botë janë gjatë vitit 2024:




Figura 6. 1. Vendet kryesore prodhuese të Pb dhe Zn

Mining Technology ka renditur vendet kryesore prodhuese të Pb dhe Zn në botë. Sipas Global data Kina është prodhuesi më i madh i Zn në botë, me 4,325 m/t prodhim vjetor. Ndërsa Bullgaria prodhuesi më i madh i Pb në botë, me 98 m/t prodhim vjetor. Përderisa vendet me minierat më të mëdha të prodhimit të Zinkut në botë sipas Global data për vitin 2024 janë:




Figura 6. 2. Minierat më të mëdha të prodhimit të Zinkut në botë

Poashtu sipas Global data vendi me minierat prodhuese të Zn më të lartë në botë është Algjeria me rreth 889 m/t prodhim Zn në vit. Kompanitë kryesore më të mëdha prodhuese të Pb në botë sipas Global Data për vitin 2024 rangohen si në vijim:




Figura 6. 3. Kompanitë më të mëdha prodhuese të Pb në botë

Mining Technology ka renditur kompanitë më të mëdha në botë që prodhojnë Plumb duke krahasuar prodhimin vjetor të kompanive kryesore të minierave të Plumbit që operojnë në pjesë të ndryshme të globit. Glencore ishte prodhuesi më i madh kryesor në botë në vitin 2023-2024, i ndjekur nga South32 dhe Teck Resources.

6.2. Perspektiva e çmimeve të metaleve të Plumbit dhe Zinkut në tregjet botërore

Çmimet e Plumbit dhe Zinkut treguan rritje qysh nga muaji janar i viti 2024. Çmimi aktual i metaleve të Plumbit dhe Zinkut është rreth 8% mbi mesataren e projektuar 5 vjeçare, një shifër që analistët nuk e prisnin, pasi që kërkesa agregate për Zink dhe Plumb shënoi ngritje në epokën post COVID-19. Në pjesën e parë të viti 2022, çmimet e metaleve Pb dhe Zn, në Bursën e Londrës kanë pësuar një rritje të konsiderueshme, sidomos Zn ku gjatë muajit prill 2022 çmimi i Zn arriti kuotën e mbi 4,500.00\$/t. Ndërsa në pjesë e dytë të viti 2022 dhe gjatë viti 2023 çmimi i këtyre metaleve bie në mesataren Pb 2,104.00\$/t dhe Zn 2,420.00\$/t. Gjatë vitit 2022-2023 sipas agjensionit të tregtisë së metaleve Eurometaux, gjysma e kapacitetit të prodhimit të Plumbit dhe Zinkut të Evropës detyrimisht ishte

jashtë linjës prodhuese si pasojë e krizës energjetike kontinentale. Pas tejkalimit të krizë energjetike kapacitetet e prodhimit të Plumbi dhe Zinkut u ngritën për 30%, në tregun e metaleve, në fund të vitit 2023 dhe fillim të vitit 2024. Në vazhdim përmes grafikoni pasqyrohet historiku i çmimeve të Plumbit dhe Zinkut gjatë dekadës së fundit.




Figura 6. 4. Trendi i çmimeve të Plumbit dhe Zinkut gjatë dekadës së fundit

Shtytësit kryesorë të ofertës dhe kërkesës së metalit të Plumbit dhe Zinkut luajnë rol të rëndësishëm në rritjen dhe rënien e çmimeve të tyre. Faktorë nxitës i rritjes së çmimeve të Plumbit dhe Zinkut mund të konsiderohet:

- Ndërprerja e furnizimit me koncentrat të Zinkut dhe Plumbit për shkak të pezullimit të prodhimit në minierat e mëdha si pasojë e pandemisë dhe krizës energjetike,
- Kufizimet e vazhdueshme mjedisore në Kinë dhe mbylljet/ndërprerjet e punës në minierat në vende të tjera,
- Rimëkëmbja e niveleve të konsumit të Plumbit dhe Zinkut në Kinë, SHBA dhe vende të tjera për shkak të rimëkëmbjes së industrisë së ndërtimit,
- Konfliktet e armatosura dhe krizat e ndryshme politike, në vendet e ndryshme të botës.

Përderisa faktorë nxitës i rrënjës së çmimeve të Plumbit dhe Zinkut mund të konsiderohet:

- Tranzicioni i tregut global të Plumbit dhe Zinkut nga deficiti në suficit;
- Rimëkëmbja në minierat e mëdha të Zinkut në Peru, Meksikë dhe Bolivi, dhe vende të tjera,

- Rritja dhe modernizimi i minierave dhe modernizimi i prodhimit të Plumbit dhe Zinkut përmes avancimit teknologjik me qëllim të përmbushjes së standardeve mjedisore.

Parashikimet e çmimit të Plumbit dhe Zinkut nga agjencitë kryesore ndërkombëtare siç janë; Industry Innovation and Science Australia (IISA) dhe parashikimet e Bankës Botërore presin një rënie të çmimit spot të Plumbit për 2%, gjatë TM1-2025, përderisa rritje të çmimit spot të Plumbit për 2.10 % gjatë TM1-2025, dhe më pas një rritje të ngadaltë të mëtejshme deri në vitin 2026.

6.3. Konkurenca në sektorin minerar

Vlerësimi i pozicionit konkurrues të kompanitë në industrinë e metaleve dhe minierave bëhet duke shqyrtuar faktorët e rrezikut të biznesit siç janë:

- Pozicioni në treg,
- Diversifikimi,
- Kostoja dhe pozicioni i rezervës,
- Rentabiliteti dhe efikasiteti operativ.

Konkurrenca e fortë e tregut në industrinë e metaleve dhe minerare mund të shihet si pozitive, marrë parasysh përfitimet nga ekonomia e shkallës, fleksibiliteti më i madh për të përshtatur prodhimin dhe kapacitetin e përgjithshëm në luhatjet e kërkesës dhe ofertës, si dhe sigurinë më të lartë mbi zingjirin e shpërndarjes dhe furnizimit poashtu edhe mundësinë më të madhe për të investuar në kërkim dhe zhvillim.

Konkurrenca për produktet e Trepça Sh.A, është relativisht e ulët pasi që kualiteti i produkteve të cilat i ofron Trepça Sh.A. i plotëson nevojat që i nënshtrohen tregut të Bursës. Minierat e Ndërmarrjes Trepça Sh.A. janë kryesisht miniera të Pb dhe Zn, si dhe kanë në përbërje dhe sasi të vogël të Argjendit dhe Arit si dhe metale tjera të çmuara. Përbajtja e komponentës mesatare të metaleve në minierën e Stantërgut, janë; Pb=4.02%, Zn=3.25%, Ag=76 g/t. Ndërsa në minierën e Artanës janë; Pb= 4.67%, Zn=6.52%, Ag=90 g/t. Tregu në të cilin momentalisht Trepça Sh.A. i shet produktet e koncentratit të Pb dhe Zn është tregu Evropian. Koncentrati i Plumbit dhe Zinkut eksportohet në Evropë, përmes tenderit publik ndërkombëtar, përderisa furnizimi me material shpenzues dhe makinerik realizohet

përmes tregut të brendshëm dhe të jashtëm. Kjo veprimtari është mjaft specifike dhe kryesisht është e lidhur me burimet dhe resurset natyrore të mineraleve metalore, prandaj konkurrenca dhe barrierat për zhvillim të ndërmarrjes Trepça Sh.A. janë minimale. Fokusi i Ndërmarrjes Trepça Sh.A. është prodhimi i koncentratit të Pb dhe Zn me kualitet sa më të lartë, me qëllim të depërtimit të produkteve tona në të gjitha tregjet botërore të metaleve duke krijuar përparësi konkurruese në raport me prodhuesit tjerë të koncentratit të Pb dhe Zn. Nga përparësitë më të mëdha të minierave të Trepçës në raport me konkurrencën, konsiderohet edhe sasia e rezervave të xehes me kualitet të lartë, mundësitë minimale të zëvendësimit të prodhimeve të koncentratit të Pb dhe Zn, si dhe eksperiencia shumë vjeçare e dëshmuar nga e kaluara në industrinë minerare. Në vazhdim prezantohet një matiks i pozicionit konkurrues i Trepça Sh.A.




Figura 6. 5. Roli i faktorëve konkurrues

Në figurën e më sipërme kemi vlerësuar rëndësinë e secilit faktorë konkurrues. 1 = nuk është i kënaqshëm, 5 = shumë i kënaqshëm.

7. Projekcioni i prodhimit në Njësitë Biznesore të Ndërmarrjes Trepça Sh.A.

Bazuar në objektivat afariste si dhe në analizën e eksploatimit dhe të prodhimit, në planin e biznesit për vitin 2025, prezantojmë projektionin e eksploatimit dhe të prodhimit sipas njësive biznesore në ndërmarrjen Trepça Sh.A.

Tabela 7.1. Planifikimi i prodhimit në Njësitë Biznesore produktive për vitin 2025

Produktet	NJBST	NJBMFKA	NJBMFKL	NJBMZ	NJBK	NJBPPP
Eksploatim i xehes (t)	145,533	42,000	165,996			
Prodhimi K/Pb (t)	4,513	1,098	5,892			
Prodhimi K/Zn (t)	5,792	2,003	7,572			
Skrap (t)	210	202	143	5		
Alumin Sulfati (t)					300	
Jarositi (t)						
Prodhimi i Rimorkiove (Njësi)						5

Në tabelën 7.1 shihet se projekcioni i eksploatimit të xehes për vitin 2025 në njësinë biznesore Miniera me Flotacion Trepça StanTërg, planifikohet të jetë 143,533 (t) xehe, me pëmbajtje mesatare të komponentës së dobishme për: Pb = 3.14%, Zn = 2.91% dhe Ag = 63.51 g/t. Përdërisa prodhimi i planifikuar i koncentratit për vitin 2025, nga miniera me Flotacion Trepça Stan Tërg është K/Pb – 4,513.18 (t), dhe K/Zn – 5,791.61 (t).

Në njësinë biznesore Minierat me Flotacion në Kishnicë dhe Artanë, eksploatimi i xehes planifikohet të jetë 42,000.00 (t) xehe, me pëmbajtje mesatare të komponentës së dobishme për: Pb = 2.50 %, Zn = 3.00 %, Ag = 113 g/t. Përdërisa prodhimi i planifikuar i koncentratit për vitin 2025, nga miniera me Flotacion në Kishnicë dhe Artanë është K/Pb – 1,098 (t), dhe K/Zn – 2,003 (t).

Në njësinë biznesore Minierat me Flotacion Kopaonik – Leposaviç eksploatimi i xehes planifikohet të jetë 42,000.00 (t) xehe, me pëmbajtje mesatare të komponentës së dobishme për: Pb = 2.76 %, Zn = 2.66 %, Ag = 37.86 g/t. Përdërisa prodhimi i planifikuar i koncentratit për vitin 2025, nga Miniera me Flotacion Kopaonik – Leposaviç është K/Pb – 5,892 (t), dhe K/Zn – 7,572 (t).

Projeksioni i prodhimit të Sulfat Aluminit në njësinë biznesore Industria Kimike, për vitin 2025 planifikohet të jetë 300 (t). Prodhimi i rimorkiove në njësinë biznesore Fabrika e Pajimeve të Procesit për vitin 2025 planifikohet të jetë 5 njësi.

8. Projekcioni i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësitë Biznesore të Ndërmarrjes Trepça Sh.A.

Në vazhdim prezantojmë burimin dhe projektionin e të hyrave dhe shpenzimeve për çdo njësi biznesore në Ndërmarrjen Trepça Sh.A. për vitin 2025.

Tabela 8. 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg për vitin 2025

Të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara për Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Gjithsej 2025
P.K. Kategoritë e të hyrave													
412 Të hyrat nga shitja e koncentratit të Pb	595,757	538,808	763,611	705,502	730,830	655,155	699,816	736,769	744,072	620,822	597,928	565,372	7,954,442
411 Të hyrat nga shitja e koncentratit të Zn	328,842	297,594	342,287	364,691	371,440	368,920	394,393	381,213	373,182	357,449	344,857	326,056	4,250,923
418 Të hyrat nga shitja e skrapit	-	220,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	220,000
Gjithsej të hyrat	924,599	1,056,402	1,105,898	1,070,193	1,102,270	1,024,075	1,094,209	1,117,982	1,117,254	978,271	942,785	891,427	12,425,365
P.K. Kategoritë e shpenzimeve													
650 Shpenzimet e pagave	639,504	660,052	656,228	651,299	660,697	660,097	633,719	639,406	660,880	658,360	657,520	654,160	7,831,922
628 Shpenzimet e energjisë elektrike	133,748	133,748	133,748	133,748	133,748	133,748	133,748	133,748	133,748	133,748	133,748	133,748	1,604,976
631 Shpenzimet e ujit	7,244	7,244	7,244	7,244	7,244	7,244	7,244	7,244	7,244	7,244	7,244	7,244	86,928
647 Shpenzimet e rentës minierare	-	-	116,109	-	-	129,460	-	-	134,843	-	-	113,906	494,317
667 Furnizimet në minierë	15,972	108,948	78,282	57,112	84,032	45,988	182,298	52,182	133,682	67,092	52,048	14,217	891,853
Shpenzimet e transportit të punëtorëve	8,125	8,125	8,125	8,125	8,125	8,125	8,125	8,125	8,125	8,125	8,125	8,125	97,500
513 Vajra	2,028	1,882	2,037	36,908	2,007	1,843	1,783	36,716	2,119	2,164	2,140	2,023	93,649
503 Reagencë	46,162	45,033	52,049	43,430	45,672	47,945	40,579	39,040	48,237	64,426	48,703	46,054	567,329
514 Karburante	8,300	7,900	7,500	9,200	8,700	8,100	7,900	7,500	7,600	8,900	10,900	10,700	103,200
510 Sfera	10,920	10,133	10,970	10,274	10,805	9,923	9,600	9,240	11,411	11,652	11,521	10,894	127,341
Burgia	8,300	8,150	8,700	8,350	8,900	7,200	8,450	8,650	8,150	8,700	8,080	8,045	99,675
627 Mjete mbrojtëse	8,550	9,200	8,700	9,500	8,100	8,050	8,300	8,570	9,300	9,700	9,400	9,350	106,720
501 Eksploziv	43,000	52,000	51,000	46,000	43,000	57,000	42,000	56,000	40,500	42,000	47,000	48,500	568,000
640 Shpenzimet e ushqimit të punëtorëve	57,083	57,083	57,083	57,083	57,083	57,083	57,083	57,083	57,083	57,083	57,083	57,083	685,000
Aparatet kundër zjarrit	-	-	-	-	2,500	-	2,500	-	-	-	-	-	5,000
Furnizim me pajisje medicinale për ambulancë	-	-	-	-	5,000	-	-	-	-	-	-	-	5,000

640	Shpenzimet e ushqimit të punëtorëve	712,400	755,144.00
	Aparatet kundër zjarrit	5,200	5,512.00
	Furnizim me pajisje medicinale për ambulancë	5,200	5,512.00
		2,080	2,204.80
668	Shpenzimet e mirëmbajtjes në minierë	15,600	16,536.00
649	Shqyrtimet teknike	7,800	8,268.00
622	Shpenzimet administrative	119,028	126,169.68
890	Shpenzimet tjera	14,047,655	14,890,515
	Gjithsej shpenzimet	(572,365)	(941,075)
	Fitim (humbja) operative	1,800,000	1,800,000
420	Të hyrat nga Subvencionet (BKK)	1,227,635	858,925
	Fitim (humbja) pas subvencioneve		

Në vazhdim prezantojmë të hyrat e përgjithshme të Njësisë Biznesore Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë për vitin 2025.

Tabela 8. 3. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë për vitin 2025

Të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara për Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej 2025
P.K. Kategoritë e të hyrave													
412 Të hyrat nga shitja e koncentratit të Pb	-	208,260	272,340	272,340	272,340	272,340	272,340	272,340	272,340	272,340	272,340	272,340	2,931,660
411 Të hyrat nga shitja e koncentratit të Zn	-	103,831	117,208	117,208	117,208	117,208	117,208	117,208	117,208	117,208	117,208	117,208	1,275,911
416 Të hyrat nga qeraja	2,393	2,393	2,393	2,393	2,393	2,393	2,393	2,393	2,393	2,393	2,393	2,393	28,716
418 Të hyrat nga shitja e skrapit	-	-	-	-	31,721	-	-	-	-	180,000	-	-	211,721
Gjithsej të hyrat	2,393	314,484	391,941	391,941	423,662	391,941	391,941	391,941	391,941	571,941	391,941	391,941	4,448,008
P.K. Kategoritë e shpenzimeve													
650 Shpenzimet e pagave	178,721	177,009	177,009	175,298	173,586	171,875	168,525	168,525	168,525	166,887	165,176	165,176	2,056,310
628 Shpenzimet e energjisë elektrike	18,000	26,272	26,272	26,272	26,272	26,272	26,272	26,272	26,272	26,272	26,272	26,272	306,992
631 Shpenzimet e ujit	2,100	2,100	2,100	2,100	2,100	2,100	2,100	2,100	2,100	2,100	2,100	2,100	25,200
647 Shpenzimet e rentës minierare	-	-	-	29,859	-	-	-	29,859	-	-	-	59,717	119,434
508 Reagensë	357	26,894	26,609	26,456	26,621	26,488	26,601	26,463	26,604	26,474	26,610	26,882	293,060
Shpenzimet e bartjes së xehes	7,180	7,180	13,642	13,642	13,642	13,642	13,642	13,642	13,642	13,642	13,642	13,642	150,780
640 Shpenzimet e ushqimit të punëtorëve	12,750	12,750	12,750	12,750	12,750	12,750	12,750	12,750	12,750	12,750	12,750	12,750	153,000
Shpenzimet e transportit të punëtorëve	7,201	7,201	7,201	7,201	7,201	7,201	7,201	7,201	7,201	7,201	7,201	7,201	86,412
514 Karburante	1,540	1,760	1,210	1,870	1,540	1,100	1,100	1,100	1,760	1,650	1,650	1,430	17,710
513 Vajra	1,406	1,047	979	813	924	1,061	624	679	924	869	869	1,406	11,602
510 Sfera çeliku	-	4,078	4,078	4,078	4,078	4,078	4,078	4,078	4,078	4,078	4,078	4,078	44,856
501 Eksploziv	5,472	5,472	5,472	5,472	5,472	5,472	5,472	5,472	5,472	5,472	5,472	5,472	65,667
Shpenzimet e rrobave dhe pajisjeve të mbrojtjes	2,750	2,550	2,525	3,750	4,500	5,550	6,340	6,000	4,300	3,120	3,100	2,450	46,935
627 Kontrolla sistematike e punëtorëve	-	-	-	10,600	-	-	-	-	-	-	-	-	10,600
667 Furnizimet në minierë	7,317	5,817	4,379	5,879	6,379	5,807	5,807	5,807	4,807	4,807	4,807	4,807	66,420
Kalibrimi i peshores	-	-	-	-	-	1,000	-	-	-	-	-	-	1,000

627	Shpenzimet e rrobave dhe pajisjeve të mbrojtjes	48,812	51,741
	Kontrola sistematike e punëtorëve	11,024	11,685
667	Furnizimet në minierë	69,077	73,221
	Kallbimi i peshores	1,040	1,102
649	Shqyrtimet teknike	44,252	46,907
670	Shpenzimet e telefonit/fiks dhe internetit	250	265
699	Shpenzimet e mbeturinave	399	423
622	Shpenzimet administrative	3,223	3,417
890	Shpenzimet tjera	10,400	11,024
	Gjithsej shpenzimet	3,652,740	3,871,905
	Fitimi (humbja) operative	973,188	1,031,579
421	Të hyrat nga Subvencionet (BKK)	1,248,000	1,322,880
	Fitimi (humbja) pas subvencioneve	2,221,188	2,354,459

Në vazhdim prezantojmë të hyrat e përgjithshme të Njësisë Biznesore Minerat me Flotacion Kopaonik – Leposaviç për vitin 2025.

Tabela 8. 5. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Minerat me Flotacion Kopaonik – Leposaviç për vitin 2025

Të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara për Njësinë Biznesore Minerat me Flotacion Kopaonik - Leposaviç														
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Gjithsej 2025
P.K	Kategoritë e të hyrave													
412	Të hyrat nga shitja e koncentratit të Pb	790,000	790,000	790,000	790,000	790,000	790,000	790,000	790,000	790,000	790,000	790,000	790,000	9,480,000
411	Të hyrat nga shitja e koncentratit të Zn	523,000	523,000	523,000	523,000	523,000	523,000	523,000	523,000	523,000	523,000	523,000	523,000	6,276,000
416	Të hyrat nga qeraja	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	24,000
418	Të hyrat nga shitja e skrapit	150,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	150,000
Gjithsej të hyrat		1,465,000	1,315,000	1,315,000	1,315,000	1,315,000	1,315,000	1,315,000	1,315,000	1,315,000	1,315,000	1,315,000	1,315,000	15,930,000
P.K.	Kategoritë e shpenzimeve													
650	Shpenzimet e pagave	676,450	676,450	676,450	676,450	676,450	676,450	676,450	676,450	676,450	676,450	676,450	676,450	8,117,400
628	Shpenzimet e energjisë elektrike	110,000	110,000	110,000	110,000	110,000	110,000	110,000	110,000	110,000	110,000	110,000	110,000	1,320,000
631	Shpenzimet e ujit	700	700	700	700	700	700	700	700	700	700	700	700	8,400
647	Shpenzimet e rentës minierare	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	54,000
508	Reagensë	59,575	59,575	59,575	59,575	59,575	59,575	59,575	59,575	59,575	59,575	59,575	59,575	714,900
501	Eksploziv	47,400	47,400	47,400	47,400	47,400	47,400	47,400	47,400	47,400	47,400	47,400	47,400	568,800
640	Shpenzimet e ushqimit të punëtorëve	31,000	31,000	31,000	31,000	31,000	31,000	31,000	31,000	31,000	31,000	31,000	31,000	372,000
	Shpenzimet e transportit të punëtorëve	26,000	26,000	26,000	26,000	26,000	26,000	26,000	26,000	26,000	26,000	26,000	26,000	312,000
514	Karburante	45,000	45,000	45,000	45,000	45,000	45,000	45,000	45,000	45,000	45,000	45,000	45,000	540,000
513	Vajra	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	72,000
510	Sfera çeliku	27,000	27,000	27,000	27,000	27,000	27,000	27,000	27,000	27,000	27,000	27,000	27,000	324,000

28

Tabela 8. 6. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve në Njësinë Biznesore Minerat me Flotacion (Kopaonik – Leposaviç për vitet 2026-2027

Të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara për Njësinë Biznesore Minerat me Flotacion Kopaonik - Leposaviç 2026-2027				
P.K	Kategoritë e të hyrave	Gjithsej 2026	Gjithsej 2027	
412	Të hyrat nga shitja e koncentratit të Pb	9,859,200	10,450,752	
411	Të hyrat nga shitja e koncentratit të Zn	6,527,040	6,918,662	
416	Të hyrat nga qiraja	24,960	26,458	
418	Të hyrat nga shitja e skrapit	156,000	165,360	
Gjithsej të hyrat		16,567,200	17,561,232	
P.K.	Kategoritë e shpenzimeve			
650	Shpenzimet e pagave	8,442,096	8,948,622	
628	Shpenzimet e energjisë elektrike	1,372,800	1,455,168	
631	Shpenzimet e ujit	8,736	9,260	
647	Shpenzimet e rentës minierare	56,160	59,530	
508	Reagensë	743,496	788,106	
501	Eksploziv	591,552	627,045	
